



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM

Nr. 189/2, datë 1.11.2019

“Mbi korrigjimin e gabimeve materiale në vendimin nr. 189, datë 25.07.2019”

Sot në datë 01.11.2019, ora 14:00, trupi gjykues, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Suela Zhegu	Anëtare
Brunilda Bekteshi	Relatore

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*”

u mblodh për t’u njohur me kërkesën e relatores së çështjes znj. Brunilda Bekteshi, për korrigjimin e gabimeve materiale në vendimin e subjektit të rivlerësimit Hysen Keta, për të cilin mbajti procesverbalin përkatës. Në procesverbal raportohet mbi arsyet e pranimit të korrigjimit të vendimit, pas të cilit arrihet në konkluzion se, në vendimin nr.189 datë 25.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në pjesën arsyetuese të vendimit, në nën pikën 2.14.5 të pikës 2.14 të titulluar “Vlerësimi i Komisionit”, në paragrafin që fillon me togfjalëshin “**Në përfundim, lidhur me këtë pasuri,**...”, në fjalinë e numërtuar “ii”, fjalët “...përgjatë viteve 1996 – 1998,...”, zëvendësohen me fjalët “...përgjatë viteve 2006 – 2011,...”.

Gjithashtu edhe në seksionin “VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES”, në paragrafin e tretë të shkronjës “A”, fjalët “...me nr. 4 dhe 5, ...” zëvendësohen me fjalët “...me nr. 3 dhe 4, ...”

Trupa gjykuese pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësitë janë vendosur dukshëm si pasojë e gabimeve materiale, në paragrafët e sipërcituar të vendimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit z. Hysen Keta;

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 189, datë 25.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit:

a. Në nën pikën 2.14.5 të pikës 2.14 të titulluar “Vlerësimi i Komisionit”, në paragrafin që fillon me togfjalëshin “**Në përfundim, lidhur me këtë pasuri,**...”, në fjalinë e numërtuar “ii”, fjalët “...përgjatë viteve 1996 – 1998, ...”, zëvendësohen me fjalët “...përgjatë viteve 2006 – 2011, ...”.

b. në seksionin “VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES”, në paragrafin e tretë të shkronjës “A”, fjalët “...me nr.4 dhe 5, ...” zëvendësohen me fjalët “...me nr.3 dhe 4, ...”

2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.

3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjykes

Xhensila Pine	Kryesuese
Suela Zhegu	Anëtare
Brunilda Bekteshi	Relatore

Sekretare gjyqesore
Denisa Kosta